



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

Nr. 218 prot.

Tiranë, më 8.5.2018

Lënda: Ftesë për pjesëmarrje në takimin e gjashtë të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave të Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik

Drejtuar: **Znj. JULIANA HOXHA**  
Drejtor Ekzekutiv i Partnerëve për Ndryshim dhe Zhvillim në Shqipëri

**Z. AURON PASHA**  
Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi

**Znj. ALBANA DHIMITRI**  
Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Politika Publike dhe Private

**Znj. KRISELA HACKAJ**  
Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim

**Z. ANDI DOBRUSHI**  
Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”

**Z. KLODIAN SEFERAJ**  
Menaxher i programit i fondacionit “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”

**ZNJ. DELINA NANO**  
Drejtor Ekzekutiv, IPSED

**Z. ELIAS MAZIOUM,**  
Drejtor Ekzekutiv, SDA

**Z. ERION TASE**  
Drejtor Ekzekutiv, Akademia për Studimet Politike

Të nderuar kolegë,

Tiranë

Ju informojmë se në zbatim të urdhrit nr.129, datë 2.9.2015, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave”, është ngritur Mekanizmi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen, i cili orienton politikat në përputhje me qasjen sistemike për zhvillimin, implementimin, vlerësimin dhe monitorimin e reformave sektoriale në këtë sektor.

Mekanizmi i Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen udhëhiqet në nivel politik nga Zëvendëskryeministri dhe rolin e sekretariatit teknik e kryen Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri.

Në koherencë me reformimin e sistemit të qeverisjes, me qëllim optimizimin e proceseve, rritjen e frytshmërisë e të cilësisë së produkteve, me lejoni t’ju informoj se janë organizuar më së shumti mbledhjet e grupeve tematike me fokus të veçantë në reformat e sektorëve respektivë.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar ky mekanizëm i mirëqeverisjes janë: qeverisja e mirë, transparenca, pjesëmarrja dhe llogaridhënia. Si i tillë, mekanizmi paraqet një prej bazave të bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile dhe vendos një komunikim të rregullt dhe të strukturuar me sektorin e shoqërisë civile me partneritet dhe transparencë në proceset e bërjes së politikave, duke siguruar dhe ruajtur në të njëjtën kohë pavarësinë e sektorit të shoqërisë civile.

Në përputhje me pikën II të urdhrit nr.129, datë 2.9.2015, të Kryeministrit, Zëvendëskryeministri përgjegjës për Mekanizmin e Menaxhimit të Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen, Ju fton të merrni pjesë në takimin e gjashtë, ditën e premte, datë 11.5.2018, ora 09:00, pranë Kryeministrit, salla e mbledhjeve, kati i tretë.

Në GMIP për Mirëqeverisjen do të miratohet:

- i. plani i veprimit i rishkuar për Strategjinë Ndërsektoriale për Administratën Publike;
- ii. raporti i monitorimit për Strategjinë Ndërsektoriale për Administratën Publike dhe do të diskutohet progresi i arritur në zbatim të rekomandimeve të SIGMA/BE-së.

Bashkëlidhur shkresës, për të dhëna më të detajuara do të gjeni agjendën e mbledhjes dhe materialet udhëzuese. Lutemi konfirmimin tuaj brenda datës 9.5.2018.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
SENIDA MESI